

## **ABSTRAKT**

### **I dëmtuari në cilësinë e dëshmitarit në procedurën penale**

Pjesëmarrja e viktimave në procedurat penale është një fenomen mjaft i ri, ndonëse konsiderohet si një instrument i rëndësishëm dhe efektiv për ti dhënë zë viktimave të shkeljeve të drejtave të njeriut kërkohet shumë punë deri tek arritja e këtij qëllimi.

Sipas Kodit të Procedurës Penale, i dëmtuari ka të drejtë dhe i lejohet të bëjë deklaratë për të gjitha faktet dhe provat që ndikojnë në të drejtat e tij dhe ka të drejtë për të bërë deklaratë mbi të gjitha faktet dhe provat. Ai ka të drejtë të marrë në pyetje dëshmitarët, t'u parashtrojë pyetje të tërthorta dëshmitarëve të palës tjetër dhe të kërkojë nga prokurori i shtetit që të thirren dëshmitarët.

Për shumë kohë viktimave të krimit nuk u është dhënë mbështetja dhe mbrojtja e duhur që e meritojnë, sot ndonëse e rregulluar paraqitet nevoja e përmirësimit të bazës ligjore për krijimin e parakushteve juridike për mbrojtjen e interesave të viktimave që kanë pësuar nga krimi.

Një nga çështjet më të rëndësishme që do të diskutohet në këtë punim është pikërisht se si mund të ndikojë pjesëmarrja e viktimës në dënimin e veprës penale dhe shqiptimin e dënimit ndaj kryerësit të saj.

Në punim do të argumentohet se pozicioni i viktimës i ndikuar nga shumë faktorë nuk është në qendër të sistemit të drejtësisë por ka avancuar në drejtim të trajtimit të tyre.

**Fjalët kyçe:** I dëmtuar; dëshmitar; mbrojtje; bazë ligjore; i mitur

**Mentori: Prof. Dr. Azem Hajdari**

**Kandidatja: Samire Berisha**